KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

BOTIMI NR.22

Buletini mujor

Shtator 2026

EUROSAI publikon raportin final të auditimit paralel ndërkombëtar mbi "Përgatitjen e qeverive për moshimin e popullsisë", pjesëmarrës edhe KLSH

Presidenca e Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) publikoi më 24 shtator 2026 raportin e përbashkët të auditimit paralel ndërkombëtar mbi "*Përgatitjen e qeverive për plakjen e popullsisë*", në të cilin ka marrë pjesë edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Raporti i përbashkët pasqyron gjetjet dhe përfundimet e auditimeve kombëtare të kryera nga Institucionet Supreme të Auditimit pjesëmarrëse lidhur me përgatitjen e qeverive për t'iu përgjigjur ndryshimeve demografike, duke u përqendruar në katër fusha thelbësore të politikave publike: planifikimi strategjik dhe burimet organizative; ofrimi i kujdesit shëndetësor; mirëqenia dhe cilësia e jetës pas reformës; si dhe qëndrueshmëria e sistemeve të pensioneve.

Auditimi u drejtua nga Zyra e Kontrollorit Shtetëror të Izraelit, me pjesëmarrjen e KLSH-së dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të Lituanisë, Maltës, Maqedonisë së Veriut, Paraguait, Polonisë, Portugalisë dhe Sllovakisë. Gjykata e Auditimit e Austrisë dhe Zyra Supreme e Auditimit e Republikës Çeke morën pjesë në auditim si vëzhgues. Auditimi vë theksin te masat që duhet të planifikojnë qeveritë për plakjen e popullsisë, që t'u përgjigjen në mënyrë efektive ndryshimeve demografike.

Gjetjet e raportit përcjellin një mesazh të qartë: ndonëse shumë vende e njohin rëndësinë e përgatitjes për plakjen e popullsisë, shpesh mbeten boshllëqe midis politikave të deklaruara dhe zbatimit real. Për sa u përket planeve qeveritare dhe aspekteve buxhetore, raporti vë në dukje sfida të tilla, si: strategjitë e fragmentuara, objektivat që nuk mund të maten në mënyrë të mjaftueshme, ndarja e paqartë e përgjegjësive, koordinimi i kufizuar ndërministror dhe mungesa e buxheteve shumëvjeçare të dedikuara. Pa një qeverisje të fortë dhe mbështetje të qëndrueshme buxhetore, planet kombëtare rrezikojnë të mbeten deklarative, në vend që të jenë operacionale.

Në fushën e shëndetësisë, raporti thekson rëndësinë në rritje të shërbimeve mjekësore në komunitet dhe në shtëpi për personat e moshuar. Këto shërbime mund të shërbejnë si alternativë ose plotësues i kujdesit institucional dhe atij spitalor, të përmirësojnë vazhdimësinë e kujdesit, të mbështesin cilësinë e jetës dhe të kontribuojnë në efikasitetin e sistemeve shëndetësore. Raporti nënvizon gjithashtu se mirëqenia pas daljes në pension varet nga autonomia, lidhja sociale, pjesëmarrja, mundësitë e punësimit, përkatësia në komunitet dhe aftësia për të adresuar vetminë te personat e moshuar.



State	Average life expectancy		
	Total	Male	female
North Macedonia	75.3	73.1	77.6
Serbia	76	73.2	78.9
Kosovo	72.2	70.5	74.1
Albania	78.3	76	80.8
Croatia	78.9	76.6	81.1
BiH	77	74.5	79.6
Austria	81.3	79.1	83.6
Slovak Republic	77.8	74.9	80.8
Israel	83	81.5	84.5
Norway	83.2	81.5	85
Germany	81.1	78.8	83.3
EU avg	81.7	79.2	84.4

Gjetjet tregojnë se, megjithëse vendet pjesëmarrëse e pranojnë rëndësinë e këtyre çështjeve, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të transformuar përgjegjësinë politike në zgjidhje efektive dhe të individualizuara.

Lidhur me sistemet e pensioneve, raporti thekson rolin qendror të pensioneve në garantimin e sigurisë sociale dhe stabilitetit ekonomik. Duke qenë se plakja e popullsisë ushtron presion demografik dhe fiskal në rritje mbi sistemet e pensioneve, gjetjet tregojnë nevojën për reforma afatgjata, mekanizma automatikë balancimi, identifikim të hershëm të rreziqeve dhe përdorimin e përvojës ndërkombëtare për të forcuar qëndrueshmërinë e sistemeve të pensioneve, duke mbrojtur njëkohësisht standardet e jetesës së personave të moshuar.

Përfundimi i përgjithshëm nga auditimi është se përgatitja për plakjen e popullsisë kërkon një kalim nga masat e fragmentuara dhe reaktive në një politikë gjithëpërfshirëse. Qeveritë duhet të krijojnë strategji të qarta kombëtare, qëllime të matshme, përgjegjësi të përcaktuara, mekanizma efektivë koordinimi, të dhëna të besueshme, monitorim të rezultateve dhe burime të dedikuara shumëvjeçare. Në të njëjtën kohë, politika publike nuk duhet të përqendrohet vetëm në sisteme dhe buxhete. Ajo gjithashtu duhet të mbrojë dinjitetin, autonominë, të drejtat, pjesëmarrjen dhe cilësinë e jetës së personave të moshuar.

Plakja nuk është një sfidë e njëhershme. Është një transformim afatgjatë që kërkon vlerësim të vazhdueshëm të politikave, zbatimit, buxhetimit dhe ndikimit. Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) kanë një rol të rëndësishëm në pyetjen nëse qeveritë po veprojnë në kohë, po planifikojnë për një afat të gjatë, po ndajnë burimet në mënyrë efektive dhe po përmirësojnë jetën e qytetarëve të moshuar në praktikë.

"*Unë besoj se gjetjet dhe përfundimet e tij do të ndihmojnë qeveritë, parlamentet, politikëbërësit dhe SAI-t në përgatitjen për një të ardhme në të cilën jetëgjatësia shoqërohet me shëndet më të mirë, siguri ekonomike, pjesëmarrje sociale dhe dinjitet njerëzor*", thekson në mesazhin e auditimit, Presidenti i EUROSAI-t, z. Matanyahu Engelman.

Bota po kalon një tranzicion të thellë demografik. Popullsitë po plaken pothuajse në çdo rajon, ndërsa nivelet e lindshmërisë bien dhe jetëgjatësia rritet. Sipas parashikimeve të Kombeve të Bashkuara (OKB) për popullsinë, përqindja e popullsisë globale të moshës 65 vjeç e lart pritet të rritet nga 17% në vitin 2024 në 33% në vitin 2054 dhe në 40% në vitin 2100. Nga fundi i viteve 2070, numri i personave të moshës mbi 65 vjeç në nivel global parashikohet të arrijë në 2,2 miliardë, duke tejkaluar numrin e fëmijëve (nën 18 vjeç), ndërsa numri i personave të moshës mbi 80 vjeç parashikohet të tejkalojë numrin e foshnjave (nën 1 vjeç).

Ky ndryshim po përqendrohet gjithnjë e më shumë në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. OBSH thekson se deri në vitin 2050, rreth 80% e të moshuarve do të jetojnë në vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme, ku sistemet mund të kenë më pak kohë dhe hapësirë fiskale për t'u përshtatur.

Auditimi i KLSH-së

Si të gjitha vendet, edhe Shqipëria po përballet me një transformim të thellë demografik, të karakterizuar nga emigracioni i vazhdueshëm, nivelet e ulëta të lindshmërisë dhe rritja e qëndrueshme e përqindjes së qytetarëve të moshuar. Këto prirje kanë ndryshuar ndjeshëm strukturën e popullsisë së vendit dhe po krijojnë presione të gjera mbi tregun e punës, qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve dhe kërkesën në rritje për shërbime sociale dhe shëndetësore. Si pasojë, plakja e popullsisë po shfaqet si një sfidë kritike e politikave, me ndikime të drejtpërdrejta në stabilitetin ekonomik dhe fiskal afatgjatë të vendit.

Në këtë kontekst, KLSH vendosi të ndërmarrë auditimin me temë "*Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim*". Institucioni identifikoi nevojën për të vlerësuar nëse qeveria ka krijuar struktura institucionale efektive, mekanizma koordinimi dhe alokime të përshtatshme burimesh për ta trajtuar plakjen në mënyrë koherente dhe strategjike.

Të dhënat demografike të marra nga INSTAT dhe të përpunuara nga grupi i auditimit tregojnë se në vitin 2024 u regjistrua numri më i ulët i lindjeve që nga viti 1990. Konkretisht, në vitin 2024 në vendin tonë u regjistruan rreth 23,310 lindje, duke vijuar një trend rënës që është vërejtur prej disa vitesh. Shtesa natyrore e popullsisë ka shfaqur një prirje rënëse për më shumë se tri dekada. Vetëm në 10 vitet e fundit, është vërejtur një ulje e shtesës natyrore me rreth 88,3%, nga 10.297 në vitin 2015 në 1.208 në vitin 2024. Sipas Censit 2023, popullsia rezidente në Shqipëri më 18 shtator 2023 ishte 2.402.113 banorë, duke shënuar një rënie prej rreth 420 mijë personash krahasuar me Censin 2011. Kjo ulje e numrit të banorëve vijon prirjen e vazhdueshme të rënies demografike që ka nisur që prej viteve '90, kryesisht si pasojë e emigracionit. Nga auditimi ka rezultuar se Shqipëria nuk ka një plan gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial që trajton fenomenin e moshimit të popullsisë.

Raporti i KLSH-së mund të konsultohet në linkun:
https://klsh.org.al/raport-perfundimtar-auditimi-planet-gjitheperfshirese-te-qeverise-dhe-aspektet-buxhetore-per-nje-popullsi-ne-moshim/

Raporti i plotë i EUROSAI-t gjendet në këtë link:
https://www.eurosai2024israel.gov.il/

BASHKËPUNIMI KLSH-KUVEND

Seanca dëgjimore në Nënkomisionin për Auditimin e Sektorit Publik mbi menaxhimin e mbetjeve urbane dhe procesin e birësimit të fëmijëve

Nënkomisioni për Auditimin e Sektorit Publik zhvilloi në datën 22.09.2026 një dëgjimore me përfaqësues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi dy raportet e auditimit të performancës me temë: "*Respektimi i standardeve për menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë*", dhe "*Procesi i birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirërritjen dhe edukimin*".

Të pranishëm në mbledhje për të paraqitur gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve ishin: z. Ardian Myslimaj, znj. Arminda Bushi dhe znj. Xhuljeta Çelaj.

Znj. Xhujeta Çelaj, Kryeaudituese në KLSH, paraqiti përmbledhjen me gjetjet kryesore mbi auditimin e kryer gjatë vitit 2024 në bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë, lidhur me menaxhimin e mbetjeve urbane. Auditimi kishte si objekt vlerësimin e masave të marra për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe analizimin e ndikimit të këtij procesi në financat publike, mjedis dhe shëndetin e komuniteteve, etj.

Nga auditimi ka rezultuar se menaxhimi i mbetjeve urbane në katër bashkitë nuk është i integruar dhe paraqet mangësi në qëndrueshmërinë financiare, planifikim, riciklim, kompostim dhe respektimin e standardeve mjedisore. Risqet më të larta janë evidentuar në Durrës për financat e bashkisë dhe, në Vlorë për ndikimin në shëndet dhe mjedis. Më pas, znj. Çelaj informoi mbi ecurinë e zbatimit të 10 rekomandimeve të lëna për subjektet e audituara.

Mbledhja vijoi me shqyrtimin e raportit të auditimit mbi procesin e birësimit të fëmijëve. Znj. Arminda Bushi, Kryeaudituese në KLSH, paraqiti një përmbledhje me gjetjet kryesore të auditimit, në fokus të të cilit ka qenë analizimi i procesit të birësimit të fëmijëve dhe vlerësimi nëse kuadri ligjor, politikat dhe praktikat e ndjekura garantojnë interesin më të lartë të fëmijës gjatë birësimit vendas dhe ndërvendas.

Konkluzioni i auditimit është se mangësitë në kuadrin ligjor, strukturat, vlerësimin e aplikantëve, vendimmarrjen, monitorimin e atashimit dhe periudhës pas birësimit, si dhe mbikëqyrjen e agjencive të huaja, kanë cenuar procesin e birësimit dhe nuk kanë garantuar plotësisht interesin më të lartë të fëmijës. Më tej, znj. Bushi informoi mbi ecurinë e zbatimit të 17 rekomandimeve të lëna në auditim për institucionet përgjegjëse në procesin e birësimit të fëmijëve. Pas paraqitjes së raporteve të auditimit, përfaqësuesit e KLSH-së iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve. Kryetari i Nënkomisionit, z. Igli Cara njoftoi se në vijim do të zhvillohet një dëgjesë me institucionet përkatëse, për të dhënë më pas rekomandimet e nevojshme.

Trajnimi mbi "Angazhimin efektiv parlamentar"

Më 2 tetor 2026, stafi i KLSH-së mori pjesë në trajnimin e organizuar nga NDI Albania me temë "*Angazhimi efektiv parlamentar*". Sesioni u fokusua në mekanizmat dhe praktikat që mund të rrisin ndikimin e gjetjeve të auditimit në Kuvend, përmes një shqyrtimi më efektiv parlamentar. Trajnimi u drejtua nga eksperti i NDI-së, z. Anthony Staddon, në bashkëpunim me përfaqësuesin e SIGMA/OECD, z. Alastair Swarbrick. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit diskutuan mbi përzgjedhjen e auditimeve me ndikim të lartë në financat publike, mënyrat e përkthimit të raporteve teknike në përmbledhje të qarta dhe praktike për deputetët, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore në komisionet parlamentare.

Forcimi i këtyre aftësive synon të kontribuojë në kthimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit në veprime konkrete, duke rritur llogaridhënien dhe transparencën në përdorimin e fondeve publike. Bashkëpunimi institucional për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit mbetet një element i rëndësishëm për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare dhe mirëadministrimin e financave publike. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit "Nga Auditimi në Veprim", të financuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), në bashkëpunim me SIGMA (OECD/EU).

"Fuqizimi i grave në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse"

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit në Kosovë dhe Entin Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kontrolli i Lartë i Shtetit realizoi auditimin e performancës me temë "*Fuqizimi i grave në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse*", me qëllim vlerësimin e efektivitetit të politikave, masave dhe mekanizmave institucionalë për rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen politike, publike dhe vendore.

Auditimi u fokusua në periudhën 2021–2025 dhe analizoi rolin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) në hartimin, koordinimin dhe monitorimin e politikave të barazisë gjinore, dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në garantimin e zbatimit të kuotave gjinore, si dhe angazhimin e bashkive Korçë, Pogradec, Divjakë dhe Kurbin në zbatimin e politikave vendore për barazinë gjinore.

Viti 2024 ka shënuar nivelin më të lartë të përfaqësimit të grave në Parlament me 35.7 % të totalit të deputetëve, duke ndikuar pozitivisht në forcimin e rolit të tyre në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse. Edhe në qeveri dhe në shërbimin civil gratë përbëjnë respektivisht 41.7 % dhe 59.8 %, por niveli i tyre i përfaqësimit ulet në pozicionet vendimmarrëse të sektorit publik.

Nga auditimi rezultoi se politikat dhe mekanizmat institucionalë kanë kontribuar në rritjen e përfaqësimit të grave, por efektiviteti i tyre mbetet i pjesshëm dhe jo plotësisht i qëndrueshëm.

Në nivel qendror, kuadri ligjor është përmirësuar, por koordinimi institucional, mbledhja e të dhënave të disagreguara sipas gjinisë dhe monitorimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore nuk janë ende në nivelin e nevojshëm për të matur progresin real.

Masat strategjike për rritjen e pjesëmarrjes dhe lidershipit të grave janë zbatuar pjesërisht dhe shpesh pa lidhje të qartë me buxhete, kosto dhe tregues të matshëm.

Auditimi evidentoi se mekanizmi i kontrollit të kuotave gjinore nga KQZ funksionon kryesisht në fazën e regjistrimit të listave zgjedhore, por nuk garanton në mënyrë të mjaftueshme ruajtjen e balancës gjinore pas shpalljes së rezultateve dhe gjatë ushtrimit të mandateve. Një nga problematikat e evidentuara lidhet me dorëheqjet e koordinuara të grave në këshillat bashkiakë pas zgjedhjeve vendore të vitit 2023, të cilat kanë cenuar objektivin e përfaqësimit gjinor.

REKOMANDIMET

Në funksion të përmirësimit të situatës, KLSH rekomandoi:

- Forcimin e rolit koordinues dhe monitorues të MSHMS-së, krijimin e një sistemi të integruar të të dhënave gjinore, vlerësimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe lidhjen e masave me buxhete e indikatorë të matshëm.
- Për KQZ-në u rekomandua forcimi i monitorimit të kuotave gjinore edhe pas ndryshimeve në lista dhe mandate, adresimi i problematikës së dorëheqjeve të koordinuara dhe caktimi i një koordinatori gjinor.
- Në nivel vendor, rekomandimet synojnë forcimin e mekanizmave të barazisë gjinore, hartimin e Planit Vendor në Bashkinë Kurbin, krijimin e evidencave mbi pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, rritjen e përfaqësimit të grave në pozicione drejtuese, dokumentimin e konsultimeve publike dhe integrimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në PBA dhe buxhetet vjetore.

Në nivel vendor, angazhimi i bashkive për zbatimin e politikave të barazisë gjinore rezultoi i pabarabartë. Bashkitë Korçë, Pogradec dhe Divjakë kanë hartuar Plane Vendore për Barazinë Gjinore 2025–2030, ndërsa Bashkia Kurbin nuk ka ende një dokument të tillë.

Edhe në bashkitë ku këto plane janë miratuar, zbatimi është në fazë fillestare dhe mekanizmat vendorë nuk janë konsoliduar plotësisht.

Përfaqësimi i grave në këshillat bashkiakë është përgjithësisht mbi kuotën minimale ligjore në disa bashki, por nuk shoqërohet gjithmonë me matje të ndikimit real në vendimmarrje.

Gratë vijojnë të jenë të nënpërfaqësuara në pozicionet e larta drejtuese dhe në drejtimin e njësive administrative. Po ashtu, konsultimet publike dhe buxhetimi i përgjigjshëm gjinor nuk dokumentohen dhe nuk zbatohen në mënyrë të plotë e të qëndrueshme.

Auditimi mbi "Efektivitetin e komisioneve rajonale të KEMP-it në trajtimin e dosjeve mjekësore"



Procesi i vlerësimit të aftësisë për punë, në kuadër të skemës së pensionit të invaliditetit, është pjesërisht efektiv, pasi nuk garanton në mënyrë të njëtrajtshme akses të shpejtë, të standardizuar dhe pa barriera.

Në këtë përfundim arriti auditimi i performancës me temë "*Efektiviteti i komisioneve rajonale të KEMP-it në trajtimin e dosjeve mjekësore*" , i cili kishte si objektiv vlerësimin e efektivitetit të kuadrit rregullator, organizimit institucional dhe funksionimit të strukturave përgjegjëse për ekspertizën mjekësore dhe trajtimin e pensioneve të invaliditetit në Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH).

Në vitin 2025 numri total i përfituesve të pensionit të invaliditetit ishte 65 606. Sëmundjet e aparatit të qarkullimit zënë vendin e parë (rreth 16 500 raste), të ndjekura nga sëmundjet e sistemit nervor qendror dhe shqisave, si dhe dëmtimet traumatike. Nga totali, rreth 96% janë përfitues si pasojë e sëmundjeve të përgjithshme dhe 4% nga aksidentet në punë ose sëmundjet profesionale. Shpenzimet për skemën e invaliditetit ishin 15 182 835 000 lekë.

Nga auditimi rezultoi se kuadri rregullator i skemës së invaliditetit ofron bazën për funksionimin e sistemit, por nuk është përditësuar për të reflektuar ndryshimet ligjore, institucionale, teknologjike dhe metodologjike të viteve të fundit. Kriteret mjekësore të përdorura për vlerësimin e aftësisë për punë nuk i janë nënshtruar proceseve periodike të rishikimit dhe përditësimit, nuk janë të aksesueshme publikisht dhe nuk mbështeten në mekanizma të formalizuar për harmonizimin e tyre me zhvillimet bashkëkohore në fushën e vlerësimit funksional të aftësisë për punë. Gjithashtu, mungojnë mekanizma të koordinimit dhe referimit ndërmjet skemës kontributive të pensionit të invaliditetit dhe skemave jokontributive të asistencës sociale, duke zgjatur procesin e trajtimit për individët që nuk plotësojnë kushtin kontributiv për përfitim në skemën e sigurimeve shoqërore.

Sistemi përballet me sfida të lidhura me kapacitetet njerëzore dhe organizative, ku strukturat rajonale dhe lokale të ISSH-së hasin vështirësi në sigurimin e specialistëve të ekspertizës mjekësore dhe administrimit të pensioneve të invaliditetit. Në disa raste, komisionet vijojnë të funksionojnë me anëtarë që kanë tejkaluar periudhën e mandatit ose moshën e pensionit, ndërkohë që procesi i rinovimit të përbërjes së komisioneve eprore nuk ka gjetur zgjidhje të qëndrueshme.

Krahas këtyre problematikave, në një pjesë të strukturave rajonale mungojnë kushtet infrastrukturore të nevojshme për administrimin e dokumentacionit dhe zhvillimin e procesit të ekspertizës mjekësore në kushte të standardizuara.

Procesi i komisionimit vijon të mbështetet kryesisht në modelin tradicional të vlerësimit fizik, ndërkohë që mundësitë për përdorimin e mekanizmave të komisionimit në distancë mbeten të kufizuara dhe të pastandardizuara. Megjithëse kuadri rregullator parashikon mundësinë e realizimit të komisionimit në distancë përmes videokonferencës në raste specifike, mungojnë procedurat e detajuara administrative dhe teknike për organizimin, dokumentimin dhe administrimin e këtij procesi.

Aplikimi për pension invaliditeti realizohet nëpërmjet platformës "e-Albania", pa mekanizma fizikë të dedikuar për informimin dhe orientimin e qytetarëve, çka krijon vështirësi shtesë për një kategori përfituesish që shpesh ndodhen në kushte të vështira shëndetësore dhe kanë nevojë për asistencë gjatë procesit të aplikimit.

Dobësi u evidentuan edhe në standardizimin dhe dokumentimin e procesit të vendimmarrjes. Dokumentimi i mbledhjeve, administrimi i dosjeve mjekësore, procesi i rikontrollit dhe dokumentacioni mbështetës nuk realizohen në mënyrë plotësisht të njëtrajtshme, duke kufizuar gjurmueshmërinë e procesit dhe transparencën e bazës mbi të cilën mbështetet vendimmarrja.

Në disa raste mungojnë elementë të rëndësishëm të dokumentacionit, ndërsa procedurat e rivlerësimit nuk zbatohen gjithmonë në mënyrë të standardizuar.

Analiza e treguesve të performancës tregon se gjatë periudhës objekt auditimi janë shënuar përmirësime në kohëzgjatjen mesatare të trajtimit të pensioneve të invaliditetit dhe në uljen e rasteve të trajtuara jashtë afatit ligjor.

Megjithatë, ndërmjet strukturave rajonale vazhdojnë të evidentohen diferenca të konsiderueshme në kohëzgjatjen e trajtimit të rasteve, respektimin e afateve procedurale dhe tregues të tjerë të performancës. Për pasojë, një pjesë e përfituesve përballen me vonesa në aksesin ndaj pensionit të invaliditetit dhe të ardhurave që lidhen me të, duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien ekonomike dhe sociale të individëve që ndodhen në një situatë të menjëhershme nevoje.

“Vlerësimi i përshtatshmërisë së politikave publike”, Maroku pret takimin vjetor të Grupit të INTOSAI-t

Në datat 15–16 shtator 2026 u zhvillua në Rabat takimi vjetor i Grupit të Punës së INTOSAI-t për Vlerësimin e Politikave dhe Programeve Publike (WGEPPP) me temë “*Vlerësimi i përshtatshmërisë së politikave publike*”.

Në takim morën pjesë përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit, anëtarë dhe vëzhgues të WGEPPP-së, të cilët diskutuan mbi një çështje me interes të veçantë për veprimtarinë audituese: nëse objektivat e politikave, programeve dhe strategjive publike vijojnë t’u përgjigjen nevojave dhe prioriteteve të shoqërisë në një mjedis ekonomik dhe social në transformim të vazhdueshëm. KLSH u përfaqësua nga znj. Valbona Gaxha, znj. Joniada Gocaj dhe znj. Arminda Bushi.

WGEPPP, si strukturë e INTOSAI-t, nxit zhvillimin dhe përmirësimin e praktikave për vlerësimin e politikave dhe programeve publike, përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve anëtare dhe shkëmbimit të metodologjive e praktikave të mira.

Në qendër të punimeve ishte dallimi ndërmjet arritjes së rezultateve të një politike dhe përshtatshmërisë së objektivave të saj me nevojat aktuale të shoqërisë. Diskutimet theksuan rëndësinë që auditimi të shqyrtojë jo vetëm nëse objektivat janë realizuar në mënyrë efektive dhe eficiente, por edhe nëse ato vijojnë të adresojnë problemet dhe prioritetet për të cilat politika është hartuar. U trajtuan aspektet konceptuale, institucionale dhe metodologjike të kësaj qasjeje nëpërmjet prezantimeve nga SAI i Indisë dhe Marokut, ndërsa Zyra e Llogaridhënies së Qeverisë së Shteteve të Bashkuara (GAO) u ndal në komunikimin me qeverinë, Parlamentin dhe palët e interesuara.

Punimet e takimit vijuan me workshop-e ku u prezantuan auditime të realizuara nga SAI-t e Marokut, Madagaskarit, Tajlandës, Algjerisë, Maldive dhe Algjerisë. Këto raste ofruan një bazë konkrete për diskutime mbi përzgjedhjen e kritereve të auditimit, përdorimin e evidencave, përfshirjen e palëve të interesuara dhe përdoruesve përfundimtarë, si dhe formulimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të mbështetura në analiza të qëndrueshme, me qëllim ruajtjen e pavarësisë, objektivitetit dhe paanshmërisë institucionale.

Në përfundim, u theksua se një vlerësim i dobishëm dhe profesional duhet të mbështetet në evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme, metodologji të qarta dhe kritere të mirëpërcaktuara. Njëkohësisht, rezultatet duhet të paraqiten në mënyrë objektive, të qartë dhe të balancuar, duke respektuar mandatin dhe kompetencat institucionale, veçanërisht kur auditimi trajton çështje që lidhen me objektivat dhe zgjedhjet e politikave publike.

Konferenca XI EUROSAI-OLACEFS në Lisbonë

“Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqërisë civile në punën e Institucioneve Supreme të Auditimit”

KLSH mori pjesë në Konferencën XI të përbashkët të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) dhe Organizatës së Institucioneve Supreme të Auditimit të Amerikës Latine dhe Karaibeve (OLACEFS), me temë “*Trendet kryesore në pjesëmarrjen qytetare dhe angazhimin e shoqërisë civile në punën e Institucioneve Supreme të Auditimit*”. Konferenca u zhvillua në datat 23-25 shtator 2026 në Lisbonë nga Gjykata Portugeze e Llogarive me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga 32 delegacione të SAI-ve.

Diskutimet u përqendruan në forcimin e bashkëpunimit dhe përmirësimin e veprimtarisë së Institucioneve Supreme të Auditimit, për t’u shërbyer më mirë qytetarëve.

Përfaqësues nga disa SAI ndanë përvojat dhe praktikat e tyre mbi përfshirjen e qytetarëve në procesin e auditimit, duke nisur nga komunikimi dhe përzgjedhja e temave, te planifikimi dhe kryerja e auditimit, deri te formulimi i rekomandimeve dhe ndjekja e zbatimit të tyre.

Mesazhi kryesor i konferencës ishte rëndësia e angazhimit të qytetarëve dhe e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile në veprimtarinë e Institucioneve Supreme të Auditimit.

Konferenca arriti në përfundimin se Institucionet Supreme të Auditimit duhet të mbeten të pavarura, objektive, rigoroze dhe teknikisht të qëndrueshme, duke forcuar njëkohësisht kapacitetet e tyre për të dëgjuar, kuptuar dhe komunikuar. Në këtë aktivitet, KLSH u përfaqësua nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Valbona Gaxha, drejtori i Drejtorisë Juridike, znj. Mirela Kolli dhe znj. Anila Alcani, përgjegjës Sektori i Protokoll-Arkivit.

Konferenca rajonale "Parandalimi i korrupsionit dhe vlerësimi i riskut në Ballkanin Perëndimor"

Në datat 30 shtator – 1 tetor 2026, u mbajt në Shkup konferenca rajonale "*Për parandalimin e korrupsionit dhe vlerësimin e riskut të korrupsionit në Ballkanin Perëndimor*", një iniciativë e përbashkët e SAI-t të Maqedonisë së Veriut dhe Institutit për Financat Publike dhe Kontabilitetin (CIPFA).

Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga institucionet përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit dhe agjencitë e prokurimit publik të vendeve të rajonit, si dhe të Institucioneve Supreme të Auditimit nga Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi. KLSH ishte pjesë e panelit të organizuar në sesionin e dytë të punimeve të konferencës, gjatë së cilit, diskutimet u përqendruan në tri tema kryesore: vlerësimi i riskut të korrupsionit në procesin e auditimit, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit, institucioneve kundër korrupsionit dhe atyre të prokurimit publik, si dhe kërkesat e Bashkimit Evropian mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe rëndësinë e bashkëpunimit rajonal.

Në këtë kuadër, u shkëmbyen përvoja dhe praktika mbi rolin e auditimit publik në identifikimin e risqeve dhe forcimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në sektorin publik. Në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional, u theksua se auditimi publik kontribuon në parandalimin e korrupsionit përmes evidentimit të dobësive të kontrollit të brendshëm, mangësive në menaxhimin financiar dhe proceseve me ekspozim të lartë ndaj riskut. Vëmendje iu kushtua prokurimit publik, si një fushë me rëndësi të veçantë për auditimin, si dhe nevojës për shkëmbim informacioni dhe komunikim ndërmjet institucioneve duke respektuar mandatin dhe pavarësinë e secilit prej tyre. KLSH u përfaqësua në konferencë nga z. Ardian Myslimaj, z. Agron Halili dhe z. Henri Axhushi.

Konferenca ndërkombëtare "Transparenca dhe llogaridhënia në shpenzimet e mbrojtjes"

Në datat 10-11 shtator 2026, KLSH mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë "*Transparenca dhe llogaridhënia në shpenzimet e mbrojtjes*", e organizuar nga Bordi Ndërkombëtar i Audituesve për NATO-n (IBAN) dhe Gjykata Rumune e Llogarive, në Bukuresht. Krahas përfaqësuesve nga IBAN, Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA), Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI), pjesëmarrës në konferencë ishin përfaqësues nga Institucionet Supreme të Auditimit të shteteve anëtare të NATO-s dhe Bashkimit Evropian, si dhe të Ukrainës dhe Republikës së Moldavisë.

Konferenca u fokusua në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira lidhur me auditimin në sektorët e mbrojtjes dhe sigurisë. Këto praktika u trajtuan në një kontekst ndërkombëtar, të karakterizuar nga rritja e shpenzimeve për mbrojtjen, zhvillimi i programeve të mëdha të investimeve dhe nevoja për të gjetur një ekuilibër të përshtatshëm midis transparencës, llogaridhënies publike dhe mbrojtjes së informacionit të klasifikuar.

Pjesëmarrësit nënvizuan rëndësinë e menaxhimit të burimeve të mbrojtjes në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente, ndërkohë që shtetet investojnë gjithnjë e më shumë në këtë sektor, i cili është bërë prioritet për sigurinë dhe mbrojtjen e qytetarëve të tyre.

Gjetja e një ekuilibri midis qëndrueshmërisë së financave publike dhe investimeve strategjike, është një nga sfidat kryesore të qeverisjes ekonomike. SAI-t kanë për detyrë të monitorojnë nga afër mënyrën se si arrihet ky ekuilibër, duke siguruar që disiplina buxhetore të mbetet një mjet për stabilitetin dhe jo një pengesë për sigurinë kolektive. Në konferencë u trajtuan edhe llojet e auditimit në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe bashkëpunimi midis IBAN-it dhe SAI-ve të shteteve anëtare të NATO-s, duke ndarë eksperienca të vlefshme për angazhimin e KLSH-së në bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies të administratës publike në fushën e shpenzimeve të mbrojtjes.

AUDITIMI IT DHE SIGURIA KIBERNETIKE

Bashkëpunimi me SAI-n e Norvegjisë, zhvillohet workshop-i “Auditimi bazë i Active Directory Domain Services”

Në kuadër të Programit Ballkanik për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit, në datat 28 shtator-1 tetor 2026, u zhvillua në Shkup workshop-i me temë "*Auditimi bazë i Active Directory Domain Services*".
Programi, i mbështetur nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë, synon të forcojë kapacitetet e Institucioneve Supreme të Auditimit në rajon për auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, kornizave të sigurisë kibernetike dhe të shërbimeve publike digjitale. Gjithashtu, përmes tij synohet nxitja e bashkëpunimit dhe krijimi i një grupi ekspertësh rajonalë të auditimit IT. Një tjetër objektiv është rritja e transparencës digjitale dhe e qëndrueshmërisë ndaj risqeve kibernetike në sektorin publik.
Pjesëmarrësit ndanë përvojën praktike dhe metodologjinë e përdorur duke prezantuar auditime në fushën e Teknologjisë së Informacionit.
“*Active Directory*” është shërbimi që organizon dhe menaxhon përdoruesit, kompjuterët dhe burimet e tjera në rrjetet e institucioneve. Përmes tij kontrollohet kush ka akses dhe në çfarë të dhënash e sisteme. Për këtë arsye, njohja e tij është thelbësore për çdo audites të Teknologjisë së Informacionit.
Pjesëmarrësit u njohën me parimet bazë të “*Active Directory*” dhe me risqet e sigurisë që lidhen me të. Në këtë aktivitet u prezantuan edhe risitë e sigurisë në versionin 2025 të “*Microsoft Active Directory Domain Services*”.
Gjatë workshop-it u praktikua nxjerrja dhe analizimi i të dhënave me komanda “PowerShell” duke përdorur një imazh “VMware” të përgatitur posaçërisht, si dhe u aplikua programi i auditimit me standardin CIS për të krahasuar gjetjet me praktikat më të mira ndërkombëtare.



TAKIMI I 19-TË I GRUPIT TË PUNËS SË EUROSAI-T PËR TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT

Zyra Shtetërore e Auditimit të Hungarisë organizoi, në datat 8–9 shtator 2026 në Budapest, takimin e 19-të vjetor të Grupit të Punës së EUROSAI-t për Teknologjinë e Informacionit (EUROSAI ITWG). Ky aktivitet ndërkombëtar iu kushtua sigurisë kibernetike, një çështje me rëndësi të veçantë në kushtet e një mjedisi gjeopolitik gjithnjë e më kompleks dhe zhvillimit të shpejtë të teknologjive.
Në takim morën pjesë rreth 60 përfaqësues nga 22 vende, ndërsa rreth 200 pjesëmarrës të tjerë, mes të cilëve dhe KLSH, e ndoqën aktivitetin online.
Gjatë sesioneve të punës, pjesëmarrësit analizuan kërcënimet kibernetike me të cilat përballen sistemet e administratës publike dhe diskutuan mbi mjetet, qasjet dhe zgjidhjet që institucionet e sektorit publik mund të përdorin për të forcuar qëndrueshmërinë e tyre ndaj risqeve digjitale.
Një nga temat kryesore të programit profesional ishte digjitalizimi i administratës publike. Gjatë diskutimeve u trajtuan mundësitë dhe sfidat që shoqërojnë procesin e transformimit digjital, si dhe praktikat më të mira në këtë fushë, me theks të veçantë në rritjen e efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe sigurisë së veprimtarisë së institucioneve publike.

Falëminderit për leximin!

© **Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH**

www.klsh.org.al E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	Kontrolli i Lartë i Shtetit klsh_org_al (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
Rruga “Abdi Toptani” Nr.1 Tiranë	Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00